



DATË/A:	15.05.2023	Nr./ Faq. Br. Str. Nr. Page. 06	Data Datum Date 16.05.2023
REFERENC-Ë:	DPKI-06-286/23	PRISHTINË	
PËR/ZA/TO:	z. Hajrulla ÇEKU, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit		
CC:	z. Feim LEKA, Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "SHOTA"		
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Yll BULESHKAJ, Drejtore i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit		
NGA/OD/FROM:	Esad EUJPI, Drejtore i Departamentit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me shqyrtimin e konfliktit të interesit lidhur me z. Feim Leka		



I nderuari z. Çeku,

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia), pas informatave të pranuar nga jashtë me dyshimin për konflikt të interesit lidhur me zyrtarin z. Feim Leka, anëtar i Këshillit Drejtues të Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve "SHOTA" (në vijim: AKKV "Shota"), konform kompetencave të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI), në cilësinë e autoritetit qendror për mbikëqyrjen dhe zbatimin e dispozitave të këtij ligji, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, 1.7 dhe paragrafi 2, të LPKI-së, nxjerrë këtë:

## OPINION

- I. Emërimi i zyrtarit z. Feim Leka - valltar/këngëtar i AKKV "Shota", në pozitën anëtar i Këshillit Drejtues të këtij ansambli dhe ushtrimi i kësaj detyre nga zyrtari në fjalë, ndalohet me dispozitën e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të LPKI-së.
- II. Agjencia kërkon nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) revokimin ose shfuqizimin e pjesëshëm të Vendimit nr. 144/2022, i datës 04.10.2022 (paragrafin 2, pika 2.4.), si dhe ta njoftoj Agjencinë për masat e ndërmarra.



## Ar sy e t i m

Agjencia ka pranuar një informatë nga jasht - raportuesi i rastit (DPKI-06-286/23), me dyshimin për konflikt të interesit lidhur me zyrtarin z. Feim Leka, Valltar - Këngëtar i AKKV "Shota", njëherit i emëruar anëtar i Këshillit Drejtues të këtij ansambli. Ndër të tjera, raportuesi i rastit ka ngritur pretendimet për konflikt të interesit në lidhje me pjesmarrjen e z. Feim Leka në komisionin për përzgjedhjen e drejtorit të AKKV "Shota" sipas konkursit nr. protokolli 5055/2022, i datës 27.10.2022, dhe në lidhje me atë se emërimi dhe të qenurit e z. Feim Leka anëtar i Këshillit Drejtues të AKKV "Shota" bie ndesh me nenin 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. të LPKI-së.

Nga shkresa me informata e parashtruar në Agjenci nga raportuesi i rastit, përveç pretendimeve për konflikt të interesit, janë ngritur edhe pretendime lidhur me (pa)rregullsinë e procesit për zgjedhjen e drejtorit AKKV "Shota" sipas konkursit të sipërpërmendur, si dhe pretendime tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit. Mirëpo, Agjencia konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit në kuptim dispozitive të LPKI-së.

Agjencia përmes shkresës zyrtare (DPKI-06-399/23), ka njoftuar zyrtarin z. Feim Leka, lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim me zyrtarin e lartë në Agjenci, me ç'rast i njëjti është njoftuar me pretendimet për konflikt të interesit dhe faktet që posedon Agjencia lidhur me këtë rast.

Zyrtari z. Feim Leka, në takimin e mbajtur ka paraqitur qëndrimet dhe argumentet e tij për pretendimet e ngritura për konflikt të interesit. Ndër të tjera ka theksuar se është valltar i AKKV "Shota" për tepër se njëzet vite, ndërsa në vitin 2022 me vendim të ministrit të MKRS-së është emëruar anëtar i Këshillit Drejtues të ansamblit në fjalë. Sa i përket pjesmarrjes së tij në komisionin për përzgjedhjen e drejtorit të AKKV "Shota" sipas konkursit të sipërpërmendur, i njëjti ka theksuar se në këtë komision ka marrë pjesë pasi që përzgjedhja e drejtorit të AKKV "Shota", sipas legjislacionit në fuqi bëhet nga Këshilli Drejtues, anëtar i të cilit ka qenë z. Feim Leka, ndërsa me asnjërin nga kandidatët për drejtor nuk konsideron se ka pasur konflikt interesi sepse nuk i ka pasur persona të afërm.

Me qëllim të sqarimit të situatës, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-02/699/23, ka kërkuar nga MKRS informata, sqarime dhe dokumentacion lidhur me konkursin për pozitën drejtor i AKKV "Shota", emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të këtij ansambli dhe statusin juridik të ansamblit në fjalë dhe të punësuarve të tij. MKRS duke u përgjigjur në kërkesën si më lartë, ka dërguar në Agjenci informatat, sqarimet dhe dokumentacionin e kërkuar (DPKI-06-02/699-1/23).

Agjencia ka analizuar në mënyrë të gjithanshme informatat e pranuar nga raportuesi i rastit, sqarimet e z. Feim Leka në takimin e mbajtur, si dhe informatat dhe dokumentacionin e pranuar nga MKRS, të gjitha këto në kuptim të dispozitive të LPKI-së, dhe më pas ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Sipas Kontratës së punës me numër protokolli 4179/2018-05, e datës 26.11.2018, e lidhur në mes të MKRS e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm në cilësi të punëdhënësit dhe z. Feim Leka në cilësi të të punësuarit, z. Feim Leka është caktuar Valltar - Këngëtar i AKKV "Shota".



Me Vendimin e Ministrit të MKRS-së nr. 144/2022 (nr. protokollit 4543/2022) i datës 04.10.2022, z. Feim Leka është emëruar anëtar i Këshillit Drejtues të AKKV “Shota” (paragrafi 2, pika 2.4.).

Sipas Vendimit si më lartë dhe përgjigjes së MKRS-së, emërimi i z. Feim Leka në Këshillin Drejtues të AKKV “Shota”, nuk është bërë në cilësi të përfaqësuesit të MKRS-së, sepse në këtë cilësi është emëruar një person tjetër.

Bazuar në përgjigjen e MKRS-së të cilën e ka pranuar Agjencia, MKRS është punëdhënës i z. Feim Leka, pasi që AKKV “Shota” është institucion vartës i kësaj ministrie.

Për më tepër, në përgjigjen e MKRS-së është theksuar se, *në bazë të legjislacionit në fuqi AKKV “Shota” është institucion i shërbimit publik, i cili rregullohet me ligj të veçantë, institucion vartës i MKRS-së [...].*

Më datë 27.10.2022, MKRS-ja kishte shpallë konkursin nr. protokollit 5055/2022, për pozitën Drejtor në AKKV “Shota”. Komisioni përzgjedhës prej pesë anëtarësh - Këshilli Drejtues i AKKV “Shota”, pjesë e të cilit ka qenë edhe z. Feim Leka, ka zhvilluar procedurat për rekrutim sipas konkursit në fjalë.

Sipas Rekomandimit për kandidatin e suksesshëm nr. protokollit 129/2023, i datës 13.01.2023, të Këshillit Drejtues të AKKV “Shota”, Divizioni i Burimeve Njerëzore në MKRS më datë 16.01.2023, ka shpallë njoftimin për kandidatin e suksesshëm (M. Xh.) nr. protokollit 139/2023.

Kundër këtij njoftimi ka parashtruar ankesë njëri nga kandidatët për drejtor, të cilën Komisioni i Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik në MKRS, e ka refuzuar si të pabazuar me Vendimin nr. 05/2023, i datës 20.02.2023.

Më pas, me Vendimin nr. protokollit 887/2023, i datës 27.02.2023, Këshilli Drejtues i AKKV “Shota”, ka miratuar listën përfundimtare lidhur me konkursin për drejtor të këtij ansambli, si dhe ka emëruar Drejtor të AKKV “Shota” kandidatin M. Xh. Rrjedhimisht, sipas përgjigjes së MKRS-së, procedura e rekrutimit për këtë pozitë është mbyllë dhe është nënshkruar kontrata e marrëdhënies së punës.

Në vështrim të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia konstatoi si në dispozitiv të këtij opinioni duke u bazuar në dispozitat e nenit 11 [Punët e ndaluara për zyrtarin], paragrafi 1, nënparagrafi 1.4., nenin 22 paragrafi 11 dhe 13, si dhe nenin 24 paragrafi 5 të LPKI-së.

I. Sa i përket konstatimit si në pikën I. të dispozitivit të këtij opinioni, fillimisht duhet të sqarohet se, pjesmarrja e z. Feim Leka në komisionin për përzgjedhjen e drejtorit të AKKV “Shota” si anëtar i Këshillit Drejtues të këtij ansambli, *vetëm për faktin se i njëjti është nëpunës i ansambli në fjalë*, apriori nuk paraqet situatë të konfliktit të interesit (në vendimmarrje). Por emërimi i zyrtarit z. Feim Leka, nëpunës i MKRS/AKKV “Shota”, në pozitën anëtar i Këshillit Drejtues të këtij ansambli dhe ushtrimi i kësaj detyre nga zyrtari në fjalë, ndalohet me dispozitën e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të LPKI-së, me të cilën është përcaktuar se:

*“1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse:*

*[...] 1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në institucione vartëse të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë.”*

INSTITUCIONI  
NËN-ORDINAR  
I AKKV



Në kuptim të dispozitës si më lartë, i ndalohet zyrtarit në këtë rast nëpunësit të MKRS/AKKV “Shota”, që të kryej punë tjera, në këtë rast si anëtar i Këshillit Drejtues të AKKV “Shota”, pasi që një angazhim i tillë ka të bëjë me emërimin e tij në institucione vartëse (AKKV “Shota”) të institucionit punëdhënës (MKRS). Kjo për faktin se, siç është konstatuar zyrtari në fjalë është nëpunës i MKRS/AKKV “Shota”, ndërsa AKKV “Shota” është institucion vartës i MKRS-së.

Për më tepër, angazhimi i z. Feim Leka në pozitën anëtar i Këshillit Drejtues të AKKV “Shota”, nuk është sipas ligjit (ex lege), pasi që siç është konstatuar më lartë, z. Feim Leka nuk është emëruar anëtar i këshillit në fjalë (ex lege) në cilësi të përfaqësuesit të MKRS-së. Rrjedhimisht, ndalesa që z. Feim Leka të ushtroj njëkohësisht funksionin e anëtarit të këshillit Drejtues të AKKV “Shota”, buron nga pozita e tij zyrtare që mbanë si nëpunës i MKRS/AKKV “Shota”.

II. Kërkesa e Agjencisë si në pikën II. të dispozitivit të këtij opinioni është bazuar në nenin 22 paragrafi 13 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Agjencia i kërkon rishqyrtimin, revokimin dhe/ose shfuqizimin e aktit të nxjerrë në konflikt të interesit organit që e ka nxjerrë atë. Që nga momenti kur Agjencia kërkon rishqyrtimin e vendimit, çdo veprim për zbatimin e tij pezullohet deri në momentin kur organi vendos për vlefshmërinë e vendimit”*, në nenin 24 paragrafi 5 të LPKI-së, me të cilin është përcaktuar se: *“Agjencia inicion procedurën administrative për revokimin ose shfuqizimin e akteve nga ana e institucionit që i ka lëshuar ato në konflikt interesi”*, si dhe nenin 22, paragrafi 11 të LPKI-së është përcaktuar se: *“Organet kompetente njoftojnë Agjencinë brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga marrja e njoftimit për veprimet e ndërmarra prej tyre.”*

Andaj në kuptim të dispozitave të sipërcituara, Agjencia kërkon nga MKRS revokimin ose shfuqizimin e pjeshëm (paragrafin 2, pika 2.4.) të Vendimit nr. 144/2022 (nr. protokollit 4543/2022) i datës 04.10.2022, pasi që siç u konstatua në pikën I. të dispozitivit të këtij opinioni, me dispozitën e nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të LPKI-së i ndalohet z. Feim Leka, që krahas pozitës si nëpunës i MKRS/AKKV “Shota” të ushtroj (pasi që është emëruar) edhe funksionin anëtar i Këshillit Drejtues të ansambilit në fjalë, si dhe ta njoftoj Agjencinë për masat e ndërmarra.

Ky opinion i referohet vetëm situatës konkrete për konflikt të interesit sipas dispozitave të LPKI-së dhe nuk trajton çështje tjera. Agjencia ka trajtuar pretendimet e parashtruara vetëm në kontekst të situatave të mundshme të konfliktit të interesit dhe ndalesave të përcaktuara me dispozitat e LPKI-së, ndërsa pretendimet tjera lidhur me (pa)rregullsinë e procesit për zgjedhjen e drejtorit të AKKV “Shota”, (pa)përshtatshmërinë e kandidatëve dhe pretendimet tjera që janë jashtë sferës së konfliktit të interesit, përkatësisht jashtë mandatit dhe kompetencave ligjore të Agjencisë, të trajtohen dhe zgjidhen brenda mekanizmave e institucioneve tjera kompetente.

Agjencia ju falënderon për bashkëpunimin.

Me respekt!